



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

PRISHTINË, 17 DHJETOR 2010
NR. REF.: RMP 76/10

**VENDIM PËR REFUZIM
TË KËRKESËS PËR MASË TË PËRKOHSHME**

Rasti nr. KI 118-10

Shoqata e Sigurimeve në Kosovë

kundër

Ligjit nr. 03/L –179 për Kryqin e Kuq të Republikës së Kosovës

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

në përbërje:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Ivan Cukalovic, gjyqtar
Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe
Iliriana Islami, gjyqtare

Mori këtë vendim për mos aprovimin e masës së përkohshme.

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues është Shoqata e Sigurimeve e Kosovës me adresë në Rr. “Enver Maloku” nr. 95, Prishtinë, përmes Fatos Zajmit, Fatbardh Makollit dhe Rustem Qehajës, respektivisht, përfaqësues të kompanive të sigurimit Illyria, Siguria dhe Sigkos.

Ligji i kontestuar

2. Parashtruesi kërkon anulimin e Nenit 14.1.7 të Ligjit nr. 03/L –179 për Kryqin e Kuq të Republikës së Kosovës. Parashtruesi, gjithashtu, kërkon një masë të përkohshme për ndalimin e zbatimit të Nenit 14.1.7 të Ligjit nga data e parashtrimit të kërkesës deri në marrjen e një vendimi meritator nga Gjykata.

Objekti i çështjes

3. Çështja ka të bëjë me Nenin 14.1.7 të ligjit të kontestuar i cili parasheh që Kryqi i Kuq i Kosovës të financohet, pjesërisht, përmes 1% të bruto premisë për sigurimin e detyrueshëm të mjeteve motorike në Kosovë.

Baza ligjore

4. Neni 113 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtutjeshëm: Kushtetuta); Neni 20 i Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtutjeshëm: Ligji), dhe nenet 52.1 dhe 54 të Rregullores së Punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtutjeshëm: Rregullorja e Punës).

Procedurat pranë Gjykatës

5. Më 26 nëntor 2010, parashtruesi ka parashtruar kërkesë në Sekretariatën e Gjykatës Kushtetuese.
6. Kryetari i Gjykatës e ka caktuar gjyqtaren Snezhana Botusharova si Gjyqtare raportuese. Ai ka caktuar edhe Kolegjin shqyrtues në përbërje të gjyqtarit Robert Carolan, kryetar i kolegjit, dhe gjyqtarëve Altay Suroy e Almiro Rodrigues.
7. Gjykata e shqyrtoi kërkesën e masës së përkohshme, në seancën e mbyllur të datës 13 dhjetor 2010.

Përmbledhje e fakteve

8. Neni 14.1.7 i Ligjit të kontestuar parasheh si në vijim:

“1. Për realizimin e detyrave dhe obligimeve të përcaktuara me këtë ligj Kryqi i Kuq i Kosovës siguron mjete financiare nga:...

1.7. sigurimi i obligueshëm i automjeteve, një për qind (1%) nga bruto primi i vlerës së sigurimit të automjetit;...”

9. Parashtruesi thekson që Ligji është në kundërshtim me këto nene të Kushtetutës:
Neni 3 - Barazia para ligjit;
Neni 10 - Ekonomia;
Neni 24 - Barazia para ligjit;
Neni 49 - E drejta për punë dhe ushtrim të profesionit; dhe
Neni 119.2 - Marrëdhëniet ekonomike-Parimet e përgjithshme.

Kërkesa për masë të përkohshme

10. Parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata anulimin e Nenit 14.1.7 të Ligjit të kontestuar mbi bazë të asaj që është jo kushtetues dhe kërkon masë të përkohshme për ndalimin e zbatimit të 1% deri në marrjen e vendimit përfundimtar të Gjykatës. Parashtruesi thekson që në bazë të të dhënave zyrtare të Bankës Qendrore të Kosovës, vlera e premisë së sigurimit të mjeteve motorike të paguara në Kosovë, shkon në vlerën prej 49, 000,000,00 € (dyzet e nëntë milion Euro) *në vit*, dhe që kostoja e industrisë së sigurimeve do të shkonte në 490, 000.00 € (katërqind e nëntëdhjetë mijë Euro) *në vit*, dhe që kjo shume do të duhet t'i paguhet Kryqit të Kuq çdo vit.
11. Neni 116.2 i Kushtetutës parasheh:

Neni 116 [Efekti Juridik i vendimeve]

2. Përderisa procedura të mos përfundojë para Gjykatës Kushtetuese, ajo mund të suspendojë përkohësisht veprimin ose ligjin e kontestuar, derisa të merret vendimi i Gjykatës, nëse konsideron që aplikimi i veprimit a ligjit të kontestuar, mund të shkaktoj dëme të pariparueshme.

12. Neni 27 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese parasheh:

Neni 27 (Masat e Përkohshme)

1. Gjykata Kushtetuese, sipas detyrës zyrtare ose me kërkesë të palës, mund të vendos përkohësisht masa te përkohshme ndaj një çështjeje që është objekt i procedurës, nëse këto masa janë të nevojshme për të evituar rreziqe ose dëme të pariparueshme, ose nëse marrja e këtyre masave të përkohshme është në interes publik.

2. Kohëzgjatja e masave të përkohshme duhet të jetë e arsyeshme dhe proporcionale.

13. Një nga kriteret për garantimin e masës së përkohshme është nëse do të shkaktohen dëme të pariparueshme. Nëse Gjykata Kushtetuese në fund gjen që Neni 14.1.7 është jo kushtetues, atëherë çfarëdo dëmi i shkaktuar qoftë ndaj parashtruesit apo kompanive individuale të sigurimeve mund të llogaritet dhe nëse është e nevojshme mund të urdhërohet kthimi i këtyre fondeve nga gjykata përkatëse. Nuk ka asgjë të parevokueshme në dëmin e shkaktuar. Parashtruesi nuk e ka dëshmuar që kompanitë e sigurimeve Illyria, Siguria dhe Sigkos, apo ndonjë kompani tjetër e sigurimeve, do të falimentojë si rezultat i zbatimit të tarifës prej 1%. Prandaj, nga kjo bazë nuk mund të argumentohet caktimi i Masës së Përkohshme të kërkuar.

14. Prandaj, pa paragjykim të ndonjë vendimi të ardhshëm të Gjykatës lidhur me pranueshmërinë apo me meritat e rastit, Gjykata Kushtetuese në seancën e datës 17 dhjetor 2010, njëzëri mori këtë:

VENDIM

I. Për refuzimin e kërkesës për Masë të Përkohshme.

II. Ky vendim iu komunikohet palëve.

III. Ky vendim publikohet sipas Nenit 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Kosovës dhe hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja Raportuese

Snezhana Botusharova, d.v.



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Prof. Dr. Enver Hasani, d.v.